REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:236466

Datë: 01.04.2021

Numri i dokumentit: 01659345

C.nr.290/2018

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditësit R., B., nga fshati ..., komuna Skenderaj, të cilin i përfaqëson me autorizim "...." me seli në Prishtine, kundër të paditurës K.,e S., "K.R" me seli në Prishtinë, që përfaqëson me autorizim ..., për kompensim të dëmi nga auto përgjegjësia, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës të shqyrtimit kryesor me dt. 22.02.2021 me pjesëmarrjen e palëve ndërgjqëse, me dt.08.03.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R., B., nga fshati ...., komuna Skenderaj.

DETYROHET e paditura K.,e S., "K. R" me seli në Prishtinë që paditësi në emër të demit që e ka pësuar në aksidentin e trafikut me dt.... në rrugën magjistrale .... – .... në Serbi në cilësinë e bashkudhëtarit me fajin e të siguruarit të paditurës të i shpërblej dëmin në shumat si në vijim.

Dëmi jo material.
Për dhimbjet fizike shumën prej 5.000 euro.
Për friken e përjetuar shumën prej 3.500 euro.
Për dhimbjet shpirtërore për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 15% shumën prej 7.500 euro.
Për dhimbje shpirtërore për shëmtim të shkallës së mesme shumën prej 4.000 euro.

Dëmi material:
Për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 600 euro.
Për ushqimin e përforcuar shumën prej 1890 euro.
Gjithsejtë shumën prej njëzet e dymijë e katërqind e nëntëdhjetë (22.490) euro shumë e cila duhet të paguhet me kamatën ligjore në normën prej 8% nga dita e gjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për hartim të padisë shumën prej 245.44 euro, takse për padi shumën prej 100 euro, për përfaqësime të avokatit shumën prej 957.21 euro, për ekspertiza mjekësorë shumën prej 300 euro, gjithsej shpenzime shumën prej 1,602.65 euro, të gjitha shumat e gjykuara duhet të paguhen në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë për dhimbjet fizike shuma 4.000 euro, për frikën e përjetuar shuma prej 3.500 euro, për zvogëlim te aktiviteti jetësor shuma prej 3.000 euro dhe për shëmtim trupor shuma prej 2.000 euro.

2019:236467

A r s y e t i m

Paditësi me dt.22.08.2018 ka ushtruar padi në gjykatë përmes "...." në Prishtinë në të cilën ka theksuar se me dt..... rreth orës ... në rrugën magjistrale .... – ... gjegjësisht në ... të Serbisë është shkaktuar aksident i komunikacionit në të cilin lëndime të rënda trupore ka pësuar paditësi .... i lindur me ...
Aksidenti i trafikut është shkaktuar kur ngasësi i automjetit për transportim të udhëtarëve autobus i tipi "....." me targa .... që të cilin e ka drejtuar .... që qarkullonte në rrugën e përmendur me lartë, kur arrijnë në Prokuple në një kthesë në të majtë nga pakujdesia dhe duke lëvizur me shpejtësi të madhe jashtë normave të lejuara të komunikacionit, e humbë kontrollin mbi automjetin e tij dhe përfundon jashtë rrugës në anën e djathtë. Si pasoj e kësaj fatkeqësie lëndime të renda trupore ka pësuar paditësi ..... Automjeti më të cilin është shkaktuar fatkeqësia – Autobusi ka qen i siguruar te e paditura më policën e sigurimit .... nr. .... e vlefshme deri me dt. 23.10.2018.
Ne këtë aksident trafiku paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore frakturë të femurit, lëndime në kokë, lëndime në qafë (mbajti qafore) si dhe lëndime tjera.
Përfaqësuesi i palës paditëse pas nxjerrjes të provave me ekspertiza mjekësore nga Dr. ..... Ortoped – Traumatolog dhe Dr. ....Psikiatër është vërtetuar natyra e lëndimeve trupore dhe llojet tjera të demit jo material dhe material dhe më dt. 10.02.2021 me parashtresë e bëri precizimin e kërkesëpadisë ashtu që për dhimbjet fizike kërkoi shumen prej 9.000 euro për frikën e përjetuar shumën prej 7.000 euro, për shëmtim trupor shumën prej 6.000 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 10,500 euro për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 600, për ushqimin e përfaqësuar shumen prej 1.890 euro gjithsej shumën prej 34.990 euro. I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,602.65 euro së bashku me TVSH në normën prej 18%, ndërsa borxhin kryesor me kamat në normën prej 8%. Në fjalën përfundimtare i propozoj gjykatës të aprovoj padinë në lartësinë e precizuar sipas parashtresës se dt.10.02.2021, sepse shumat e kërkuara janë në përputhje me lëndimet e rënda trupore më pasoja për jetë qe i ka pësuar paditësi nga të cilat pasoja vuan edhe e sot e kësaj dite dhe përherë.
Sa i përket memorandumit të mirëkuptimit të siguruar nga gjykata i lidhur me dt. 19.04.2013 ndërmjet Shoqatës së Sigurimeve të Serbisë dhe ....-së në Kosovë është vetëm për të lehtësuar procedurat e shtetaseve të dy vendeve që kompensimin fillimisht ta kërkojnë në .... e tyre nacionale dhe më pas Byroja përkatëse kërkon regresin ne Byronë e shtetit tjetër ose direkt në kompani e sigurimeve e cila e ka lëshuar policën. Ky memorandum assesi nuk e përjashton që pala e dëmtuar të kërkoi kompensim direkt nga kompania e cila e ka lëshuar policën e aq me tepër kur pala paditëse dhe e paditura kanë vendbanim dhe seli në Republikën e Kosovës të gjitha këto janë në përputhje me LSDA.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt.09.10.2019 e kontestoj pjesërisht kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia e dëmit me arsyetim se shumat e kërkuara janë paushallë dhe të pa bazuara dhe të pa specifikuara e po ashtu në kundërshtim të plotë me kriteret e përcaktuara për lartësinë e dëmeve jo material qe i ka miratuar .... dhe Ministria e Shëndetësisë.
Palës paditëse ne procedurat administrative i është ofruar oferta ne shumen prej 4.243 euro për të gjitha format e dëmit material dhe jo material.
E paditura gjatë shqyrtimit kryesor me dt. 25.11.2020 e ka ndryshuar qëndrimin e me parshim si në përgjigjen ne padi dhe tani e kundërshtoj padinë edhe për nga baza juridike ku për te paditurën nuk është kontestues që ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në Serbisë mirëpo në bazë te nenit 15 par1 te Ligjit 04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia i mbulon dëmet e shkaktuara në Republikën e Kosovës e që në ketë rast aksidenti ka ndodhur në

2019:236467

Serbi për shkak se nuk ka mbulesa sigurues. Në baze të Memorandumit të mirëkuptimit që është lidhur në mes të Shoqatës së sigurimeve të Serbisë dhe Republikës të Kosovës. i lidhur ne Bruksel me dt.19.04.2013 përgjegjës për trajtimin e dëmeve dhe kompensimin e kërkesave është shoqata e sigurimeve ne Serbi.
Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare mbeten pran kundërshtimeve të padisë dhe ofertës për zgjidhje të kontestit me marrëveshje por jo të gjykohet çështja nga kjo gjykate pasi qe edhe gjykata Supreme e Kosovës në rast të ngjashëm ka konstatuar qe këto qeshje nuk mund te gjykohen nga gjykatat e Kosovës për demin e një territori në një shtet tjetër.
E kundërshtoj zgjerimin e padis pjesërisht pasi qe e njëjta nuk përkon me natyrën dhe shkallën e lëndimeve dhe nuk është statisfaksion real.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 7 dhe 8 te LPK-së i nxori dhe i administroj të gjitha provat e shënuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt. 22.02.2021 një nga një dhe te gjitha se bashku duke i krahasuar njërën me tjetrën nga të cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuara.

Gjykata në bazë të referatit të padisë deklarimit të palëve ndërgjyqësve provave në shkresat e lendes aktgjykimi penal P.nr,302/2018 i dt. 17.01.2019 i gjykatës në ... është vërtetuar fakti se me dt.02.05.2018, rreth orës 4:40 në rrugën ... në vendin e quajtur ....ka ndodhur aksident i trafikut ashtu që autobusi i udhëtareve i tipit ".... " me targat e regjistrimit ... që e ka drejtuar .... nga .... duke mos i përshtatur rregullave të komunikacionit për Sigurinë në rrugë me ç'rast ka bërë rrezikim të sigurisë në komunikacion duke e rrezikuar jetën e udhëtareve sepse ka drejtuar automjetin me shpejtësinë prej...km në orë ku ka qenë e kufizuar shpejtësia e lëvizjes në 50 kmh, e ka humbë kontrollin mbi automjetin ka kaluar në anën e kundërt të drejtimit të lëvizjes dhe ka dalë jashtë rruge me ç'rast ka ardhë deri te rrotullimi i autobusit dhe paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore.
Kontestuese në mes të palëve ka mbetur fakti i të drejtës për realizimin e kompensimit të dëmit në gjykatën kompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndore ne Republikën e Kosovës apo në vendin ku është shkaktuar aksidenti.
Në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se paditësi ka të drejtë në shpërblim të demit si pale e tretë në përputhje me dispozita të nenit 9.1 të Ligjit për Sigurimet e Detyrushme nga Autopërgjegjësia nr.04/L-018 ku thuhet "Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon" ndërsa në paragrafin 1.1 thuhet " dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik" , ndërsa në dispozitat e nenit 15 par.2 të këtij ligji shprehimisht është përcaktuar "Sigurimi nga autopërgjegjësia, përpos dëmeve të shkaktuara në Republikën e Kosovës, mbulon edhe dëmet në territorin e shteteve anëtare të sistemit të kartonit të gjelbër nëse nuk është kontraktuar ndryshe". Në rastin konkret gjykata vlerëson se padia për shpërblim të demit është e bazuar në dispozitat ligjore të përmendura më lartë dhe memorandumi i lidhur me dt.19.04.2013, ndërmpejt Shoqatës së Sigurimeve të BKS-së në Kosove dhe sigurimeve në Serbi, shërben vetëm për lehtësim të procedurave të shtetasve të dy vendeve për kërkesat e rimburismeve – regreseve në byrotë e shteteve tjera dhe assesi nuk është pengesë për ushtrim të padisë në gjykatën kompetente në Republikën e Kosovës për kompensim të dëmit në përputhje me dispozitat ligjore të përmendura më lartë.

Pas vërtetimit të fakteve se e paditura është përgjegjës për shpërblim të dëmit në bazë të fajësisë nga autopërgjegjësia sipas kontratës së sigurimeve gjykata nxori provat përmes ekspertizave mjekësorë nga Dr. ... ortoped traumatolog dhe Dr..... Psikiatër, në seancë me dt. 02.02.2021.

Në bazë të mendimit dhe të konstatimit mjekësor Dr. .... Ortoped- Traumatulog është konstatuar se paditësi në aksidentin e trafikut të dt.02.05.2018 ka pësuar lëndime trupore:

2019:236467

Thyerje të pjesës së sipërme të ashtit të kofshës së djathte – është e operuar e sanuar me Ostrosintezë sipas ....(Pllakë, vida- fiksues i brendshëm), vërejtje për shkak të defektit në murin e brendshëm të ashtit të kofshës si pasoj e thyerjes kemi një kënd të lehtë në ngjitje.
Lëndimi karakterizohet si lëndim i rëndë trupor i cili ka shkaktuar:
Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë një orë, dhimbje të intensitetit të rendë 5 ditë kohe pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit mesatar 50 ditë (kohë e nevojshme për fillimin e konsolidimit primar kockor në raport me moshën dhe defektin kockor në murin e brendshëm), dhimbje të intensitet të ulet sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin ekzistojnë edhe sot e kësaj dite dhe në fund të dhimbjeve të kofshës të cilat manifestohen sidomos natën, nuk mund të shtrihet në krahun e djathtë, dhimbje të cilat shpërthejnë në ndryshime klimatike dhe ne sforcime fizike.
Bazuar në natyrën e rëndë të lëndimeve trupore kohëzgjatje dhimbje fizike gjykata e ka aprovuar shumën prej 4.000 euro që i përgjigjet përafërsisht shkallës së dëmit të pësuar.
Sipas ekspertit mjekësor paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor të shprehur në shkallen prej 15% për shkak të kufizimit mesatar të lëvizjes së kërdhokullës të djathë dhe ndryshimit të këndit të ashtit të kofshës bazuar në pikat 2.2.2 b dhe pikat 2.2.9 të tabelës të ZAJ e ...-së e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, bazuar në konstatimin e ekspertit dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe pasojat e mbetura gjykata ka vlerësuar se paditësi do të përjeton dhimbje shpirtërorë sa herë që e ndien këtë zvogëlim të aktivitetit jetësor në raport me gjendjen shëndetësorë para këtij lëndimi dhe për këtë gjykata e aprovoi shumën prej 7.500 euro. Te paditësi ka mbetë shëmtim trupor i shkallës së mesme për shkak të dy vrajave operatore në kofshën e djathtë me gjatësi prej ... cm dhe 1...cm dhe duke marr për bazë shkallën e shëmtimit vendin , moshën e paditësit gjykata e ka aprovuar shumën prej 4.000 euro ngase paditësi do të përjetoj dhimbje shpirtërorë sa herë që këto vraja postoperatore janë të dukshme gjatë pushimeve në detë apo në ndonjë qendër rehabilituese.
Paditësi ka pasur nevojë për ndihem e huaj në kohëzgjatje për 6 muaj ndihëm e cila ka konsistuar në përgatitjen e ushqimit mbajtjen e higjienës personale ndihem dhe veshmbathje, patericave që e ka marrë nga familja, gjykata e ka aprovuar shumën prej 600 euro e cila i është një shumë minimale prej 100 euro në muaj prandaj gjykata e aprovoj në tersi të bazuar. Për ushqimin e përforcuar i cili ka qenë i nevojshme[m për 9 muaj i pasur me mineralë vitamina proteina për konsolidim më të shpejtë të lëndimeve trupore është aprovuar shumen prej 7 euro në ditë gjithsejte prej 1.890 euro që është në përputhje me rregulloren e BQK-së prej 7 euro në ditë.

Gjykata e vlerësoj ekspertizën mjekësore të cilës i dha bindje të plote si prove e besueshme, sepse ekspertiza përmban të gjitha elementet e nevojshme të dhëna në bazën e njohurive profesionale dhe arsye te mjaftueshme të cilat gjykata i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në ketë çështje kontestimore.
Në dispozitat e nenit 183 par. 1 i LMD-se janë përcaktuar llojet dhe format e shpërblimit të demit jo material dhe atë për dhimbjet fizike frikën e përjetuar dhe format tjera te demit. Ne rastin konkret gjykata në përputhje më par. 2 të këtij neni është kujdesur për të mirën e cenuar nga akti dëmtues dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim.
Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruar gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për demit qe i është shkaktuar paditësit si person i trete në aksidentin e trafikut për çka e paditura është e obliguare që paditësit ti kompensoi demin meqë shkaktari dëmit ka lidhur kontrate me të padituren sipas polices se sigurimit .... për periudhën prej dt. 23.10.2017 deri me dt. 23.102018 dhe ne këto rrethana e drejta e kompensimit nga autopërgjegjësia është e bazuar në dispozitat e nenit 136 dhe 159 par.4 të LMD- se nr.04/L-077.

Gjykata duke u bazuar ne gjendjen faktike të vetëtuar si dhe duke vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë se demit jo material, e posaçërisht duke marr parasysh

2019:236467

natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore që janë shkaktuar paditësit, moshën e tije sipas vlerësimit me ekspertiza mjekësore, gjykata i aprovoi kërkesëpadinë pjesërisht në vlerat e shpërblimit të demit si në dispozitiv të aktgjykimit, duke vlerësuar se shpërblimi është real dhe objektiv qe është ne përputhje me demin dhe ky shpërblim është ne përputhje me natyrën e lëndimeve dhe pasojat e mbetura.

Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimit paraqesin një statisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve që i ka pësuar paditësi në aksidentin e trafikut, duke marrur parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitat e nenit 183 te LMD, standardin jetësor mesatar në Kosove dhe praktikat e deri tanishme të gjykatave.

Janë vlerësuar të gjitha kundërshtimet e të padituröes të cilat fillimisht kanë të bëjnë me lartës e shumave të precizuara me kërkesëpadi që janë pjesërisht të bazuara ndërsa kundërshtimi se paditësi është dashtur që të ushtroj padi për kompensim të demit në Serbi atje ku ka ndodhur aksidenti rezulton te jete i pa bazuar sepse kjo çështje në mënyre shprehimore është rregulluar me dispozitat e nenit 15 par 1 i LSDA nr. 04/L-018 prandaj këto kundërshtime nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendos në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala paditëse ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore është mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së ashtu që i pranohen shpenzimet e përgjithshme të specifikuara ne dispozitiv te aktgjykimit në shumën e përgjithshme 1,602.65 euro, ndërsa obligimi i të padituröes që dëmi të paguhet më kamatën ligjore në normën vjetore prej 8% është i bazuar në dispozitat e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së.

Mesa u tha me lartë bazuar ne dispozitat e nenit 143 te LPK-se u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, DEGA NË SKENERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM.
C.nr.290/2018, me dt.08.03.2021

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykim, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.